



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 424/3 Prot.

Tiranë, më 10.11.2016

**V E N D I M**

**Nr. 121, datë 10/11/2016**

**“Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Bashkia Vorë”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë “Mbi verifikimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 8, datë 25.01.2016 “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve civilë të institucionit, Bashkia Vorë”,

**Vërej se:**

Në zbatim të Vendimit nr. 120, datë 05.11.2015, “Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Vorë”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është realizuar mbikëqyrja në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 8, datë 25.01.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve civilë të institucionit, Bashkia Vorë”, në të cilin është vendosur:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes tematike, në lidhje me verifikimin e procesit të deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve, të cilët në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, në subjektin Bashkia Vorë dhe në Njësitë Administrative në përbërje të saj, i cili është pjesë e këtij vendimi.

1. Njësia përgjegjëse, në lidhje me pozicionin e punës “*Specialist Arkive*”, të veprojë si më poshtë:
  - Të rishikojë vlerësimin e këtij pozicioni në raport me fushën e shërbimit civil, duke marrë parasysh vendin në strukturë dhe detyrat funksionale që ka në kompetencën e tij.
  - Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, të rolit të pozicionit në shërbimin civil, të vijojë procedura me nxjerrjen e aktit të deklarimit të statusit të punësimit në kategorinë “*nëpunëse civile*”, në pozicionin “*Specialiste Arkive*”, për nëpunësen \*\*\*\*\*, e cila, aktualisht, është e punësuar në këtë pozicion pune, në zbatim të nenit 67, pika 3, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*”, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.
2. Njësia përgjegjëse, të fillojë procedurën për revokimin e akteve administrative, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, që parashikojnë plotësimin e një pozicioni të lirë pune detyrimisht nëpërmjet një procedure të rregullt konkurrimi, si më poshtë:
  - Revokimin e aktit administrativ nr. 59, datë 15.01.2015, për emërimin e nëpunëses \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”.
  - Revokimin e aktit administrativ nr. 26/2, datë 16.09.2015, për emërimin e nëpunësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm Financiar*”.
  - Revokimin e aktit administrativ nr. 13/19, datë 01.09.2015, për emërimin e nëpunëses \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialiste në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*”.
  - Revokimin e aktit administrativ nr. 13/20, datë 01.09.2015, për emërimin e nëpunësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Përgjegjës në sektorin e Bujqësisë dhe Veterinarisë*”.
  - Revokimin e aktit administrativ nr. 13/26, datë 01.09.2015, për emërimin e nëpunëses \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Shërbimeve Sociale*”.
  - Revokimin e aktit administrativ nr. 13/21, datë 01.09.2015, për emërimin e nëpunëses \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun*”.
  - Revokimin e aktit administrativ nr. 65/4, datë 01.10.2015, për emërimin e nëpunësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve*”.

- Revokimin e aktit administrativ nr. 60, datë 15.01.2015, për emërimin e nëpunëses \*\*\*\*\* , në pozicionin “Përgjegjëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore”.
- Revokimin e aktit administrativ nr. 55, datë 15.08.2014, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialist në Zyrën e Informacionit”, pranë Njesisë Administrative Prezë; revokimin e aktit administrativ nr.230, datë 08.06.2015, për deklarimin e tij nëpunës civil në periudhë prove; revokimin e aktit administrativ nr. 13/144, datë 01.09.2015, për riemërimin në pozicionin “Specialist Shërbimesh”, pranë Njesisë Administrative Prezë.
- Revokimin e aktit administrativ nr. 25, datë 15.04.2014, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* , në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Financës”, pranë Njesisë Administrative Prezë; revokimin e aktit administrativ nr. 224, datë 08.06.2015, për deklarimin e tij nëpunës civil në periudhë prove; revokimin e aktit administrativ nr. 13/43, datë 01.09.2015, për riemërimin në pozicionin “Specialist Finance”, pranë Njesisë Administrative Prezë.

Rekomandohet njësia përgjegjëse, që vendet e punës, “Sekretar i Përgjithshëm”; “Përgjegjës në Sektorin e Bujqësisë dhe Veterinarisë ”; “Përgjegjëse në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun”; “Përgjegjës në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”; “Përgjegjëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore”; “Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm Financiar”; “Specialiste në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”; “Specialiste në Sektorin e Shërbimeve Sociale” (pranë Bashkisë Vorë) dhe “Specialist Shërbimesh”; “Specialist Finance” (pranë Njesisë Administrative Prezë), t’i shpallë vende të lira, për t’u plotësuar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji dhe në koherencë me implementimin e reformës territoriale.

3. Njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 128 të Kodit të Procedurave Administrative, “Ndryshimi dhe zëvendësimi i akteve administrative”, duhet të ndryshojë aktet e deklarimit të statusit të punësimit, duke i shtuar faktin që nëpunësit duhet të konsiderohen nëpunës civilë në periudhë prove, si më poshtë:
- Ndryshimin e aktit administrativ nr. 579/4, datë 29.09.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësin \*\*\*\*\* , në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, pranë Njesisë Administrative Bërxull, i emëruar pas ristrukturimit në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, pranë Bashkisë Vorë.
  - Ndryshimin e aktit administrativ nr. 229, datë 08.06.2015, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësen \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialiste në Zyrën e Tatim Taksave”, pranë Njesisë administrative Prezë, emëruar pas ristrukturimit në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Financës”, pranë Bashkisë Vorë.
  - Ndryshimin e aktit administrativ nr. 579/4, datë 29.09.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësin \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialist në Zyrën e Tatim Taksave”, pranë Njesisë Administrative Bërxull.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse, duhet të marrë masat për të zbatuar të gjitha detyrimet ligjore që parashikon ligji për punonjësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA); për caktimin e një punonjësi më të vjetër për t'u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori dhe pas kësaj duhet të shprehet për konfirmimin, ose jo të nëpunësve civilë në periudhë prove.

4. Njësia përgjegjëse, në kushtet e riorganizimit të strukturës dhe organikës së njësisë administrative, me qëllim që të respektohen kërkesat e ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, të bëjë klasifikimin e saktë të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e çdo pozicioni, si dhe të njehsojë pozicionet specifike me ato të përcaktuara në nenin 19 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar. Këto pozicione, të evidentohen në çdo rast, në strukturën dhe organikën përkatëse, ku të jetë shënuar edhe kategoria e pagës për çdo pozicion pune.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve në vendimin e mësipërm, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" dhe në Rregulloren "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Vendimin nr.8, datë 25.01.2016.

Me vendimin nr.66, datë 31.05.2016, të Komisionerit u ngrit grupi i punës, i cili u paraqit në subjektin, Bashkia Vorë në datën 03.06.2016 dhe i kërkoi personit përgjegjës, nëpunëses \*\*\*\*\* , dosjet e personelit dhe dokumentacionin shkresor të dalë në zbatim të rekomandimeve të Komisionerit.

Në përfundim të verifikimit, rezultoi se :

- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 2 të vendimit, njësia përgjegjëse, ka vlerësuar se ky pozicion pune hyn në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil dhe se personi që kryen këtë detyrë në bazë të përshkrimit të punës kryen funksionin për ushtrimin e autoritetit administrativ, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, "*Nëpunës civil*", nr.19/1, dt.31.01.2016, për nëpunësen \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës "*Specialiste arkive*" në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Vorë.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 3 të pjesës urdhëruese të vendimit nr.8, datë 25.01.2016, të Komisionerit, rezultoi se:
  1. Në mbështetje të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.118, dt.05.03.2014, "*Për procedurën e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së*" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.108, dt.26.02.2014 "*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*", Bashkia Vorë, me shkresën nr.919 prot.,

dt.29.03.2016, "Njoftim për publikun", ka bërë shpalljen e pozicionit të punës "Sekretar i Përgjithshëm" në faqen zyrtare të SHKP.

Pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm është parashikuar për herë të parë në strukturën e miratuar me Urdhrin nr.21, dt.01.02.2016 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vorë" dhe po ushtrohet nga nëpunësja civile \*\*\*\*\* , deri në përfundimin e procedurës së konkurimit sipas parashikimeve ligjore, për arsye se ekzistenca e këtij pozicioni pune është e domosdoshme për funksionimin normal të punës në Bashkinë Vorë.

2. Me Vendimin nr.23/16, dt.16.02.20156 punonjësi \*\*\*\*\* është liruar nga detyra "Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm Financiar" dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës.
3. Punonjësja \*\*\*\*\* nga momenti i daljes së vendimit të Komisionerit dhe deri në momentin e verifikimit të zbatimit të vendimit, u konstatua se ishte me Raport për Leje Barrë lindje nr.1409. Ndodhur në këto kushte, bazuar në nenin 6 të ligjit nr.7703, dt.11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, punonjësja ka mbrojtje të detyrueshme e për rrjedhojë njësia përgjegjëse nuk mund të ndërpresë marrëdhënien e punës gjatë kohës së raportit. Në momentin e mbarimit të raportit mjekësor, do të revokohet akti administrativ nr.13/19, dt.01.09.2015 i emërimit të punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin "Specialiste në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit".
4. Me Vendimin nr.21/27, dt.01.03.2016, punonjësit \*\*\*\*\* me detyrë "Specialist" në Sektorin e Bujqësisë dhe Veterinarisë i është ndërprerë marrëdhënia e punës.
5. Me Vendimin nr.20/10, dt.01.02.2016, punonjësja \*\*\*\*\* është emëruar në detyrën "Nëpunës Vendor i Barazisë Gjimore", pozicion ky që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Nëpunësi vendor i barazisë gjimore, referuar nenit 64, gërma "k" të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Bashkisë.
6. Në mbështetje të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, dt.18.03.2014, "Për procedurën e rekrutimit, të përzgjedhjes të periudhës së proves, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.108, dt.26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", Bashkia Vorë, me shkresën nr.2167 prot., dt.2.06.2016, "Njoftim për publikun", ka bërë shpalljen e pozicionit të punës "Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore" në faqen zyrtare të SHKP.  
Pozicioni, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është parashikuar për herë të parë në strukturën e miratuar me Urdhrin nr.21, dt.01.02.2016 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vorë" dhe po ushtrohet nga nëpunësja \*\*\*\*\* , deri në përfundimin e procedurës së konkurimit sipas parashikimeve ligjore, për arsye se ekzistenca e këtij pozicioni pune është e domosdoshme për funksionimin normal të punës në Bashkinë Vorë.
7. Me Vendimin nr.74/3, dt.02.11.2015, punonjësi \*\*\*\*\* është emëruar në detyrën "Këshilltar", pjesë e kabinetit të Kryetarit të Bashkisë, pozicion ky që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

8. Me Vendimin nr.14, dt.11.01.2016, punonjësja \*\*\*\*\* është liruar nga detyra “Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore” dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Në strukturën e miratuar me Urdhërin nr.21, dt.01.02.2016 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vorë”, pozicioni i mësipërm është i paplotësuar.
  9. Me Vendimin nr.34/1, dt.01.03.2016, punonjësja \*\*\*\*\* është liruar nga pozicioni që mbante në shërbimin civil dhe është emëruar në detyrën “Protokoluese” pranë Njesisë Administrative Prezë, pozicion ky që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.
  10. Me Vendimin nr.34/3, dt.01.03.2016, punonjësi \*\*\*\*\* është liruar nga pozicioni që mbante në shërbimin civil dhe është emëruar në detyrën “Arkëtar” pranë Njesisë Administrative Prezë, pozicion ky që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 4 të vendimit, njësia përgjegjëse në përputhje me nenin 128 të Kodit të Procedurave Administrative, “Ndryshimi dhe zëvendësimi i akteve administrative”, ka zbatuar rekomandimin e Komisionerit duke nxjerrë:
- a. Aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.19/3, dt.31.01.2016, “nëpunës civil në periudhë prove”, për punonjësën \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist” në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit. Me nxjerrjen e këtij akti administrativ konsiderohet i zbatuar rekomandimi i pikës 4 të pjesës urdhëruese të Vendimit nr.8, datë 25.01.2015.
  - b. Aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.19/2, dt.31.01.2016, “nëpunës civil në periudhë prove”, për punonjësën \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialiste” në Sektorin e Financës pranë Bashkisë Vorë. Me nxjerrjen e këtij akti administrativ konsiderohet i zbatuar rekomandimi i pikës 4 të pjesës urdhëruese të Vendimit nr.8, datë 25.01.2015.
  - c. Aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.19/4, dt.31.01.2016, “nëpunës civil në periudhë prove”, për punonjësën \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist” në Zyrën e Tatim Taksave, pranë Njesisë Administrative Bërxull. Me nxjerrjen e këtij akti administrativ konsiderohet i zbatuar rekomandimi i pikës 4 të pjesës urdhëruese të Vendimit nr.8, datë 25.01.2015.

Me shkresën nr.986 Prot., dt.01.04.2016, drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, bazuar në nenin 24 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është kërkuar trajnimi i nëpunësve të mësipërm, të cilët janë në periudhë prove.

- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 5 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse në kushtet e riorganizimit të strukturës dhe organikës sipas Urdhrit nr.21, datë 01.02.2016 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vorë” kishte bërë klasifikimin e pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil sipas parashikimeve të nenit 19 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Sa më sipër, u verifikua reagimi i njesisë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, u mbajt procesverbali i konstatimit dhe përfundimisht, arrij në konkluzionin se Vendimi nr. 8, datë 25.01.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të

*mbikëqyrjes në lidhje me procesin e deklaramit të statusit të punësimit të nëpunësve civilë të institucionit, Bashkia Vorë*”, është zbatuar në tërësi, nga ana e subjektit, **Bashkia Vorë**, përveç përfundimit të procedurave të konkurimit për pozicionet e punës, “*Sekretar i Përgjithshëm*” dhe “*Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore*”, të cilat do të jenë objekt i një verifikimi të mëvonshëm.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **V E N D O S A:**

1. Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Bashkia Vorë.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar në tërësi rekomandimet e Vendimit nr. 8, datë 25.01.2016 ,“ *Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me procesin e deklaramit të statusit të punësimit të nëpunësve civilë të institucionit, Bashkia Vorë*”, përveç përfundimit të procedurave të konkurimit për pozicionet e punës “*Sekretar i Përgjithshëm*” dhe “*Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore*”, të cilat do të jenë objekt i verifikimit të mëvonshëm.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Bashkia Vorë, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**